

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Mehmet Ndrecaj, anëtar të kolegjit, me zyrtarin ligjor Faton Xhaqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: R.B., rr. "...", nr. .. – Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.M. Av. nga Prishtina, rr "...", nr.150 Prishtinë, kundër të paditurës: Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, "Sheshi Nëna Terezë" nr.,36 Prishtinë, të cilin e përfaqëson F.SH. me autorizim, për shkak të kompensimit të pagave për shpërblim jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, C.nr.123/18, i datës 27.11.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë **06.05.2019**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themelë ankesa e të paditurës: Korporata Energjetike e Kosovës sh.a Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, C.nr.123/18, i datës 27.11.2018, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar, C.nr.123/18, i datës 27.11.2018, ka vendosur që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.B. nga Fushë Kosova.

Në pikën e I-rë të dispozitivit ka vendosur që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, Prishtinë, që paditësit R.B. nga Fushë Kosova., në emër të shpërblimi të tri pagave jubilarë, t'ia paguaj shumën prej 1.488.00 euro, (njëmijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë euro), me kamat ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data 27.11.2018 e marrjes së Aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

Në pikën e II-të të dispozitivit ka vendosur që e paditura, paditësit t'ia kompozoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën e përgjithshme prej 270 euro.

Kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar Aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovon ankesën e Korporatës Energjetike të Kosovës, sh.a, si të bazuar dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.123/18, i datës 27.11.2018, të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me Aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**Ankesa e të paditurës është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi R.B. me datë 16.01.2018, ka paraqitur padi ndaj të paditurës, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a Prishtinë, duke kërkuar kompensimin e pagave për shpërblimin jubilar.

Me datë 27.11.2018 është mbajtur seancë e shqyrtimit kryesorë. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, administrimit të provave dhe dëgjimit të palëve në procedurë, jashtë seancës së shqyrtimit kryesor ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar C.nr.123/18, i datës 27.11.2018, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të Aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të Aktgjykimit të atakuar Gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Gjykata vlerëson se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar konform dispozitave të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, nenit 52, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, ndërsa paditësi ka dalur në pension me datë 19.01.2016, në kohën kur vepron dhe është në fuqi Kontrata Kolektive e Kosovës, për çka edhe vendosi që kërkesëpadija e paditësit të miratohet si e bazuar.

Lartësia e kërkesëpadiisë është bazuar sipas listës së pagave nga e paditura, nr.4246 të datës 14.08.2016, paga mujore 496.00 euro, e njëjta pagë mujore paditësit i është caktuar në shumën prej 496.00 euro, dhe në kontratën e punës nr.4246/0 të datës 01.03.2014 dhe vendimit për pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e daljes në pension në pension nr. 1169 të datës 25.07.2016, ku e paditura paditësit i'a pranon të drejtën në tri paga përcjellëse dhe i'a paguan tri paga me rastin e daljes në pension në shumën prej 1488.00 euro, sipas pagesës mujore prej 496.00 euro, nga gjendja faktike si më lartë. Shumën prej 1488 euro, e kërkon paditësi prej tri paga jubilarë sipas pagesës mujore në muajt e fundit para pensionit prej 496 euro, lartësia e kërkesës nuk është kontestuese se nga ana e palës së paditur.

Gjykata i morri si të pa papranueshme pretendimet e të paditurës se e paditura nuk ka pas mjete financiare për pagesën e këtyre pagave dhe se padia është paraqitur pas afatit nga se gjendja faktike dhe juridike është ndryshe dhe ajo për faktin se paditësi ka dalur në pension me datë 01.08.2016, i ka pranuar tri paga përcjellëse pas daljes në pension nga e paditura në shumën prej 1488.00 euro, ndërsa padin në Gjykatë për pagë jubilarë e ka parashtruar me datë 16.01.2018, çka dmth, se padia është paraqitur brenda afatit ligjor të paraparë me dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës dhe konform nenit 376 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me bazën juridike të kërkesë padisë ju ka referuar Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, nga nenin 52, dispozitave të Ligjit të punës nga nenin 87, nenit 376 të LMD-së, ndërsa sa i përket kamatës ligjore prej 8%, i është referuar 382 të LMD-së, dhe vendimin për shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi

2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se Aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore - LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave materiale duke pretenduar se padia e paditësit është e parashkruar pasi që Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur lidhur me këtë çështje, dhe se kjo është e rregulluar me nenin 87 të Ligjit të Punës i thekson se citoj *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”* Andaj Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur lidhur me këtë çështje juridike – kontestimore duke e refuzuar kërkesën e të paditurës me arsyetimin se “paditësi ka dal në pension me datë 01.08.2016, i ka pranuar tri paga përcjellëse pas daljes në pension nga e paditura, ndërsa padinë në Gjykatë e ka parashtruar me datë 16.01.2018, që do të thotë se padia është paraqitur brenda afatit ligjor të paraparë me dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës dhe konform nenin 376 të LMD-së”, ndërsa këtë arsyetim e mbështet edhe Gjykata e Apelit si të drejtë dhe të ligjshëm.

Dispozitave të marrëveshjes kolektive të cilave iu referohet e paditura si palë ankuese në raport me shpërblimin jubilar më konkretisht nenit 52, ku nuk përmendet çështja e pensionimit, ato dispozita rregullojnë situatën kur e paditura mundet që në procedurë administrative në bazë të vullnetit të saj brenda një muaji t’ia paguajë paditësit shpërblimin jubilar për çdo dhjetë vite, mirëpo të njëjtat nuk e detyrojnë paditësin që pikërisht pas kalimit të afatit një muajor duhet të kërkohet kjo e drejtë në të kundërtën do të kemi parashkrim. Këto dispozita nuk parashohin kufizime se shpërblimi jubilar nëse nuk paguhet me kohë, apo nëse në kohën kur është arritur përvoja e punës nuk ka qenë në fuqi një marrëveshje kolektive, shpërblimet e tilla nuk kërkohen më vonë, respektivisht me rastin e pensionimit. Pra nuk ka kufizime të tilla se shpërblimi jubilar nuk mund të kërkohet me rastin e pensionimit po pas pensionimit, kjo nuk qëndron, sepse me vet faktin që përmend periudhat 10 vjeçare, dhe nëse brenda asaj kohe nuk është kryer obligimi i pagesës nga ana e punëdhënësit, ka mundësi që punëdhënësi i fundit të paguajë shpërblimet jubilarë krejt në fund të gjitha të akumuluar. Ndërtimi i dispozitës në fjalë është formuluar në atë mënyrë që paditësit nuk ia parasheh humbjen e të drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmes mbrojtjes gjyqësore të drejtën e paraparë me këtë kontratë, pas pensionimit nëse më herët punëdhënësi nuk ia ka paguar këto shpërblime, andaj rrjedhimisht me të drejtë është vendosur

nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse kërkesëpadia është e bazuar, nuk kemi të bëjmë me kërkesa të parashkruara.

Gjykata e shkallës së parë drejt e ka zbatuar nenin 52 paragraf 1, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, përcaktohet se: “ I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: a) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; b) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij dhe c) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Me paragrafin 2 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: “ Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, ndërsa në paragrafin 3 të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet se: Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf ”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit ti paguaj tri paga në emër të shpërblimit jubilar, me të drejtë është bazuar në nenin 52 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive në Kosovë e lidhur me date 18.06.2014 dhe e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015.

Vendimi sa i përket kamatës nga Gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 paragraf 2 i LMD-së, me nr. 04/L-077 i datës 30.05.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.1014/19, me datë 06.05.2019**

**Kryetari i kolegjit**

***Faton Ademi, d.v***